

UDHËZUES MBI VLERËSIMIN E RISKUT

Ky udhëzues u dedikohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë brenda vendit të punës, të cilët kanë përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Ky dokument duhet të përdoret si një mjet ndihme për të zhvilluar vlerësimin e riskut në vendin e punës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -
Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of
Finance, Labour and Transfers

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
IDENTIFIKIMI I RISKUT	2
PËRFSHIRJA E PUNËTORËVE.....	2
KUSH MUND TË LËNDOHET DHE SI?.....	3
VLERËSIMI I RISKUT DHE CAKTIMI I PRIORITETEVE.....	5
ZHVILLIMI I KONTROLLEVE TË RISKUT	6
REGJISTRIMI DHE KOMUNIKIMI I VLERËSIMIT TË E RIKSUT	8
AUDITIMET	9
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	9
SHTOJCA	10



HYRJJE

Duke qenë në cilësinë e një punëdhënësi dhe pjesë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë brenda biznesit tuaj, ju keni një përgjegjësi për të kontrolluar rreziqet në vendin e punës. Vlerësimi i riskut do t'ju ndihmojë të përmbushni përgjegjësitë tuaja, ndërsa mbron punëtorët tuaj nga rreziqet që ndërlidhen me llojin e punës që kryeni çdo ditë. Vlerësimi i riskut duhet të jetë në pajtim me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, i cili parasheh vlerësimin e riskut në vendet e punës, si dhe Rregulloren e MPMS-së Nr. 02/2021 mbi përgatitjen e vlerësimit të riskut. Ky Udhëzues pasqyron kërkesat të cilat parashikohen në rregulloren e lartpërmendur.

Çfarë është vlerësimi i riskut?

Procesi i vlerësimit të riskut kalon nëpër disa etapa të cilat fillimisht na ndihmojnë të identifikojmë rreziqet në vendin e punës, duke mësuar se kush mund të lëndohet dhe si të trajtohen me prioritet rreziqet kryesore dhe, më e rëndësishmja, si të zhvillohen masat e kontrollit të cilat do të lejojnë në eliminimin, zbutjen dhe zvogëlimin e këtyre rreziqeve.

Për disa nga punët që kryeni mund të ketë ligje dhe rregullore specifike që përcaktojnë kontrollet të cilave duhet t'u nënshtroheni, të cilat duhet të përfshihen në vlerësimet tuaja të riskut. Ky Udhëzues përqendrohet në secilin hap që duhet të ndërmerreni me qëllim të zhvillimit të plotë të vlerësimit të riskut dhe kontrollet pranë vendit të punës të cilat duhet të ndërmerren dhe t'u komunikohen punëtorëve tuaj.

Rreziku është një burim i mundshëm rreziku që shkakton dëmtim të shëndetit dhe jetës së punëtorëve dhe të tjerëve.

Kjo rregullore përshkruan katër faza të përgjithshme të aktivitetit për vlerësimin e riskut në vendin e punës të cilat përfshijnë:

1. Identifikimin e rreziqeve në vendin e punës
2. Vlerësimin e nivelit të riskut duke përfshirë vlerësimin e masave të zbatuara dhe propozimin e masave shtesë
3. Përgatitjen e vlerësimit të riskut dhe dokumenteve shoqëruese
4. Rishikimin e vlerësimit të riskut.

Vlerësimet e riskut duhet të regjistrohen në letër ose në mënyrë dixhitale, të rishikohen dhe përditësohen rregullisht, qoftë në baza vjetore apo kurdo që ndryshon puna juaj ose vendi juaj i punës, gjë që kërkon përditësimin e vlerësimeve të riskut.

Punëtorët duhet të inkurajohet që të raportojnë çdo shenjë dhe simptomë të lëndimit dhe sëmundjes tek ju ose përfaqësuesi i punëtorëve në fazë të hershme para se ato të bëhen më serioze, kështu që hapat për të zvogëluar rrezikun të mund të ndërmerren.





Rreziku (RR) është një kombinim i Probabilitetit (P) që një person mund të dëmtohet, ose mund të shkaktohet ndonjë dëm tjetër dhe Ashpërsisë (A) së këtij dëmi ose dëmtimi. $RR = P \times A$.

Rregullorja gjithashtu i referohet termave të mëposhtëm:

- **Vlerësimi i riskut në vendin e punës** - nënkupton një procedurë që përcakton nivelin e riskut që është kombinimi i gjasave që i punësuar mund të lëndohen ose të kenë efekte shëndetësore që vijnë nga rreziqet që ekzistojnë në mjedisin e tij/saj të punës, si dhe nivelin e pasojave të mundshme të lidhura me lëndimet në punë, sëmundjet profesionale dhe efektet e tjera shëndetësore.
- **Rreziku në vendin e punës** - nënkupton çdo burim të dëmtimit të mundshëm ndaj të cilit mund të ekspozohet një i punësuar në punë, dhe që mund të shkaktojë dëm ose efekte të dëmshme në shëndetin e të punësuarve.

IDENTIFIKIMI I RREZIKUT

Detyra e parë në zhvillimin e vlerësimit të riskut është identifikimi i saktë i rreziqeve të mundshme në vendin tuaj të punës.

Rreziqet mund të identifikohen përmes një sërë aktiviteteve, të cilat mund të ndërmerren duke kryer një shëtitje përreth vendit të punës me qëllim që të vërehen, vihen në pah dhe regjistrohen rreziqet. Ne duhet të mendojmë për aktivitetet, proceset ose substancat që përdoren e që mund të dëmtojnë punonjësit tuaj ose të dëmtojnë shëndetin e tyre. Ndonjëherë punëtorët mësohen aq shumë me vendin e tyre të punës sa që nuk mund t'i vënë re disa nga rreziqet që u kanosen.

Këtu janë disa metoda që mund të përdoren për t'ju ndihmuar juve dhe punëtorëve tuaj të identifikoni rreziqet kryesore në vendin e punës:

- Rishikoni çdo evidentim tuaj të aksidenteve dhe incidenteve - ato mund të zbulojnë rreziqe
- Rishikoni veprimet jo të rregullta, ku rreziqet mund të jenë më pak të dukshme
- Rishikoni detyrat, substancat ose ekspozimet që paraqesin rreziqe afatgjata
- Lexoni udhëzimet e prodhuesve për materialet dhe pajisjet që përdoren.

Në pjesën vijuese do të shohim rëndësinë e përfshirjes së punëtorëve në identifikimin e rreziqeve dhe zhvillimin e kontrolleve të riskut.



PËRFSHIRJA E PUNËTORËVE

Është e rëndësishme që punëtorët të përfshihen në procesin e vlerësimit të riskut për të siguruar që kontrollet janë efektive dhe që metodat e sigurta të punës janë të mundshme. Pasi të jetë kryer



vlerësimi i riskut, duhet të siguroheni që të gjitha palët e përfshira të informohen rreth gjetjeve të vlerësimit, duke u siguruar që kontrollet janë kuptuar dhe janë duke u zbatuar.

Përfshirja e punëtorëve në të gjitha aspektet e shëndetit dhe sigurisë do t'i bëjë ata pjesë aktive në procesin e zhvillimit të procedurave dhe praktikave të sigurisë. Këtu janë disa ide të cilat mund të përdoren në përfshirjen e punëtorëve tuaj në çështje të shëndetit dhe sigurisë, përfshirë zhvillimin e vlerësimit të riskut dhe kontrolleve:

- **Kutitë e sugjerimeve:** Punëtorët duhet të kenë një vend ku mund të shprehin sugjerimet ose shqetësimet e tyre në çdo kohë qoftë në formë elektronike ose fizike. Është e dobishme nëse punëtorëve u ofrohet mundësia të mbesin anonim.
- **Raportimi i riskut:** Ngjashëm me kutitë e sugjerimeve, punëtorët kanë nevojë për një adresë ku mund të raportojnë shkeljet ose incidentet në mënyrë të përshtatshme, duke qenë plotësisht të sigurt se raportimet e tyre do të merren seriozisht dhe do të adresohen.
- **Trajnim mbi sigurinë:** Ose përmes kurseve të modifikuara virtuale ose bisedave të sigurisë në të gjithë departamentin, menaxhmenti duhet vazhdimisht të trajnojë punëtorët duke u përkujtuar atyre praktikatat e sigurta dhe rreziqet e zakonshme ndaj të cilave duhet pasur kujdes.
- **Ushtrime të sigurisë:** Në disa raste, trajnimet fizike duhet të shoqërohen me ushtrime të sigurisë për të siguruar që punëtorët do të dinë saktësisht se si të reagojnë në mënyrë që të mbrojnë veten dhe njerëzit përreth tyre në raste të aksidenteve.

Ndonjëherë përfshirja e punëtorëve quhet "konsultim". Ky është një proces i dyanshëm midis jush dhe punëtorëve tuaj ku ju, 1) flisni me njëri-tjetrin për çështjet e shëndetit dhe sigurisë - dëgjoni shqetësimet e tyre dhe paraqisni shqetësimet tuaja, 2) kërkoni dhe ndani pikëpamje dhe informacione, dhe 3) merrni parasysh pikëpamjet e punëtorëve para se të merrni vendime. Të gjitha qasjet e paraqitura më sipër mund t'ju ndihmojnë si në zhvillimin e vlerësimeve efektive të riskut ashtu edhe në qasjen konstruktive për krijimin e një kulture pozitive të sigurisë në vendin tuaj të punës.

Mbani mend pikat e mëposhtme për të siguruar angazhim efektiv me forcën tuaj punëtore në zhvillimin e vlerësimit të riskut dhe vendosjen e kontrolleve:

- Respektoni të gjithë punëtorët e përfshirë.
- Angazhoni punëtorët që kanë njohuri në lidhje me vlerësimin e riskut.
- Inkurajoni një debat të hapur dhe transparent pasi një gjë e tillë do të ndihmojë në sigurimin e një rezultati më të mirë.
- Pranoni kontributet pozitive të punëtorëve.
- Ofroni vlerësimin tuaj për punëtorët e përfshirë në zhvillimin e vlerësimit të riskut.

KUSH MUND TË LËNDOHET DHE SI?

Pasi të identifikohen rreziqet, si pjesë e përfshirjes së punëtorëve, duhet të merret parasysh fakti se kush mund të lëndohet dhe mënyrat si mund të lëndohen ata. Për të vlerësuar një gjë të tillë, duhet të merret parasysh se





kush mund të jetë i pranishëm në vendin e punës ku rreziku është i pranishëm. Kjo do të përfshijë punëtorë, por edhe të tjerë, të tillë si kontraktorë ose vizitorë, të cilat gjithashtu mund të lëndohen.

Për secilin rrezik ju duhet të jeni plotësisht në dijeni se kush mund të lëndohet - kjo do t'ju ndihmojë të identifikoni mënyrën më të mirë të kontrollit të riskut. Kjo nuk do të thotë të kesh një listë me emrat e të gjithë punëtorëve, por për më tepër të jesh në gjendje të identifikosh grupe njerëzish (p.sh. punëtorët që punojnë në hapësira të mbyllura, ata që punojnë në lartësi, vizitorët në vendin e punës ose kalimtarët e rastit).

Mbani mend informacionin në vijim sa herë merrni parasysh se kush mund të lëndohet dhe dhe mënyrat si mund të lëndohen ata:

- Disa punëtorë mund të kenë kërkesa të veçanta, p.sh. punëtorët e rinj në moshë apo pa përvojë, punëtorët emigrantë, nënat e reja ose gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët e përkohshëm, kontraktorët, punëtorët që punojnë nga shtëpia dhe punëtorë të pavarur duke përfshirë punëtorët me sëmundje ekzistuese.
- Mendoni për njerëzit që mund të mos jenë gjatë gjithë kohës në vendin e punës, siç janë vizitorët, kontraktorët dhe punëtorët e mirëmbajtjes.
- Mendoni rreth qytetarëve të cilët mund të lëndohen nga aktivitetet tuaja të punës. Nëse ndani një vend pune me një biznes tjetër, merrni parasysh se si ndikon puna juaj tek të tjerët dhe si ndikon puna e tyre tek ju dhe punëtorët tuaj.
- Bisedoni me njëri-tjetrin dhe sigurohuni që kontrollet të jenë duke u zhvilluar. Pyesni punëtorët tuaj nëse është lënë dikush anash.

Si mund të dëmtohen punëtorët?

- Përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me aparatit elektrik
- Rrëshqitjet, pengimi ose rënia
- Goditja nga objektet
- Rënia nga lartësia
- Lëndimi nga ndonjë aktivitet fizik
- Asfiksioni
- Ngatërrimi
- Ekspozimi ndaj zhurmës së tepruar
- Ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme
- Goditja nga impianti ose pajisjet në lëvizje.





VLERËSIMI I RISKUT DHE CAKTIMI I PRIORITETEVE

Pasi rreziqet të jenë identifikuar, atëherë duhet të vendosni rreth probabilitetit të dëmit i cili mund të ndodh, d.m.th. nivelin e riskut dhe çfarë duhet të bëni në lidhje me të. Rreziku është një pjesë e jetës së përditshme dhe nuk pritet që ju të të eliminoni të gjitha rreziqet. Ajo që duhet të bëni është të siguroheni që jeni të informuar rreth rreziqeve kryesore dhe gjërave që duhet t'i ndërmerrni për t'i menaxhuar ato me përgjegjësi. Në përgjithësi, ju duhet të bëni gjithçka “që është e mundshme në mënyrë të arsyeshme” për të mbrojtur njerëzit nga lëndimi. Kjo nënkupton baraspeshimin e nivelit të riskut kundrejt masave të nevojshme për të kontrolluar rrezikun real duke llogaritur vlerën monetare, kohën ose shqetësimin.

Vlerësimi i riskut duhet të përfshijë vetëm atë që me arsye pritet që ju të jeni të informuar - nuk pritet të parashikoni rreziqe të paparashikueshme. Shikoni se çfarë aktualisht jeni duke bërë dhe masat e kontrollit që tashmë keni vendosur.

Pasi të keni renditur rreziqet e juaja dhe të keni identifikuar se kush mund të lëndohet dhe mënyrat se si mund të lëndohen ata, atëherë mund të filloni me procesin e vlerësimit të riskut duke përdorur pesë hapat e paraqitura më poshtë:

1.

Merrni parasysh probabilitetin e riskut që në të vërtetë shkakton dëm në vendin e punës gjatë kryerjes së detyrave.

2.

Kategorizoni probabilitetin në shkallshmëri, duke filluar nga “i ulët”, “i mesëm” dhe “i lartë”, ku “i lartë” paraqet rrezik të sigurt.

3.

Merrni parasysh ashpërsinë nëse rreziku ka shkakuar dëm dhe si ka ndikuar tek njerëzit dhe detyrat e punës që ata kanë qenë duke kryer.

4.

Kategorizoni ashpërsinë e riskut në shkallë “i ulët”, “i mesëm” ose “i lartë”, ku rreziku “i mesëm” mund të rezultojë në një rast të ofrimit të ndihmës së shpejtë dhe “i lartë” mund të rezultojë në një lëndim serioz ose fatalitet.

Pyete veten: A mund ta largoj rrezikun? Nëse jo, si mund t’i kontrolloj rreziqet në mënyrë që dëmi të mos jetë i mundshëm?

Disa hapa praktikë që mund të ndërmerrni përfshijnë:

- Duke provuar një opsion më pak të rrezikshëm
- Duke parandaluar qasjen ndaj rreziqeve
- Duke organizuar punën për të zvogëluar ekspozimin ndaj riskut
- Duke dhënë pajisje mbrojtëse
- Sigurimi i ambienteve të mirëqenies, të tilla si ndihma e shpejtë dhe pajisiet e

Vlerësimi i rrezikut		Ashpërsia		
		I ulët - 1	I mesëm - 2	I lartë - 3
Probabiliteti	I lartë - 3	3	6	9
	I mesëm - 2	2	4	6
	I ulët - 1	1	2	3



Vendosni rezultatin përfundimtar brenda një diagrami të nivelit të riskut, siç është shembulli i treguar në të djathtë, dhe vendosni rreziqet sipas kategorisë.

5.

ZHVILLIMI I KONTROLLEVE TË RISKUT

Aspekti më i rëndësishëm i çdo vlerësimi të riskut është identifikimi i kontrolleve për të menaxhuar rrezikun. Për ta bërë këtë duhet të kemi parasysh hierarkinë e kontrolleve të riskut.

Diagrami 1 - Hierarkia e Kontrolleve të Riskut përcakton gamën e opsioneve të kontrollit në lidhje me prioritetet e preferuara.

Diagrami 2 – Formulari i Vlerësimit të Riskut tregon një shembull të një modeli të vlerësimit të riskut i cili duhet të plotësohet dhe më pas t'i komunikohet punëtorëve përpara se të fillojnë me detyrën.

Diagrami 1 – Hierarkia e Kontrolleve


Hierarkia e kontrolleve të riskut sugjeron që kontrolli më efektiv për menaxhimin e çdo rreziku është eliminimi i riskut.

Kur një gjë e tillë nuk është e mundur, ne duhet të zëvendësojmë pajisjet, materialin ose rrezikun me ndonjë opsion tjetër që është më pak i mundshëm. Kur një gjë e tillë nuk është e mundur, dhe ndërsa lëvizim poshtë në hierarkinë e kontrolleve të riskut, ne mund të zbatojmë kontrolle inxhinjerie (të tilla si platformat e ngritura dhe lëvizëse, të cilat mundësojnë punën në lartësi). Nëse kjo nuk është në dispozicion, atëherë mund të përdoret format e kontrollit administrativ, siç janë procedurat ose lejet.

Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP) shihen gjithmonë si opsioni i fundit i kontrollit brenda hierarkisë së kontrollit të riskut. Monitorimi i ekspozuar ndaj rreziqeve të rrezik të lartë duhet të administrativ.

shëndetit të punëtorëve të veçanta shëndetësore me konsiderohet si një kontroll

më efikas



më pak efikas



Diagrami 2 – Formulari i Vlerësimit të Riskut

Forma e treguar këtu është një shembull se si një vlerësim i riskut mund të plotësohet si një regjistër fizik. Kjo formë kërkon që të ndërmerren hapa specifik gjatë procesit të vlerësimit të riskut.

Duhet të fillohet me identifikimin e detyrës, pastaj kërkohet nga vlerësuesi të marrë parasysh rreziqet që lidhen me detyrën, pastaj kush mund të ekspozohet ndaj riskut dhe çdo kontroll tjetër ekzistues.

Në këtë pikë, kontrollet ekzistuese të riskut vlerësohen duke përdorur një metodologji të pikëzimit - Probabiliteti (P) dhe Ashpërsia (A), këto rezultate shumëzohen për të siguruar një Peshë të Riskut (PRR) - sa më e lartë të jetë pesha e riskut, aq më i lartë është rreziku.

Pasi të vlerësohen kontrollet ekzistuese dhe nëse kontrollet nuk janë të përshtatshme, duhet të konsiderohen kontrolle shtesë dhe rreziku të vlerësohet përsëri.

Ky duhet të jetë një dokument i cili do të kontrollohet nga vetë kompania.

Vendi:

Operacioni:

Data e vlerësimit të riskut:

Data e rishikimit:

Vlerësimit i riskut është bërë nga:

Vlerësimi i rrezikut - Modeli i formës													
P - Probabiliteti		A - Ashpërsia		PRR - Peshë e Rrezikut		PxA		I lartë / I mesëm / I ulët					
Detyra	Rreziku	Kush është i ekspozuar	Kontrollet ekzistuese	Kontrollet shtesë				P	A	PRR	RL		
				P	A	PRR	RL						
Riparimi i kulmit të ndërtesës tri katëshe përfshirë zavendësimin e tjegullave dhe gypave të drenazhit.	Rënja e personit apo materialit nga lartësia për shkak të: - Skajeve të hapura që paraqiten në punë - skajeve frontale - hapësirave në kulm ose kulmit të brishtë.	Punëtorët në kulm të jashtëm dhe mundësia për lëndimin e kalimtarëve dhe vizitorëve në nivel të tokës.	Angazhimi i kompanisë kompetente për skele për të ngritur dhe mirëmbajtur skelet e jashtme dhe qasjen në kulm.	3	2	6		1	2	2			



Nëse kërkohen të ndërmerren masa tjera të çfarëdo lloji qofshin ato si pjesë e masave të kontrollit siç janë niveli i zhurmës, kushtet e ambientit, nivelet e rrezatimit etj., atëherë ato duhet të regjistrohen dhe monitorohen ato sipas formës së VR-së. Pajisjet e kalibruara/verifikuara ose ofruet të akredituar të një shërbimi të tillë duhet të përdoren për këtë qëllim.

REGJISTRIMI DHE KOMUNIKIMI I VLERËSIMIT TË E RISKUT

Mbani një regjistër të gjetjeve të rëndësishme - rreziqeve, mënyrën se si njerëzit mund të lëndohen prej tyre dhe mjetet që keni në dispozicion për të kontrolluar ato rreziqe. Çdo regjistrim duhet të jetë i thjeshtë dhe i përqendruar në kontrolle. Përdorni, për shembull, modelin për regjistrimin e vlerësimit të riskut të treguar më lart në Diagramin 2.

Një vlerësim i riskut duhet të jetë i përshtatshëm për qëllimin, ai duhet të demonstrojë:

- Që është bërë një kontroll i duhur i të gjitha rreziqeve të mundshme.
- Që njerëzit që mund të preken nga rreziku janë konsultuar dhe/ose janë marrë parasysh si pjesë e vlerësimit të riskut.
- Që të gjithë rreziqet e dukshme dhe të rëndësishme janë marrë parasysh dhe gjithashtu edhe numri i njerëzve që mund të përfshihen.
- Që masat e marra paraprake janë të arsyeshme, dhe rreziku i mbetur është i ulët.
- Që keni përfshirë në proces të vlerësimit të riskut punëtorët tuaj ose përfaqësuesit e tyre.

Një vlerësim i riskut duhet të rishikohet rregullisht:

Pak vende pune mbeten të njëjta, ato shpesh ndryshojnë me kalimin e kohës. Për shembull, mund të ndryshoni llojin ose fushëveprimin e punës ose mund të sillni pajisje, substanca dhe procedura të reja që mund të ndryshojnë rreziqet në vendin tuaj të punës. Prandaj është e kuptueshme që të rishikoni atë që jeni duke bërë në mënyrë të vazhdueshme, të shikoni përsëri vlerësimin e riskut dhe të pyesni veten:

**COHET TË SIGURONI
QË VLERËSIMIT TUAJA
TË RISKUT TË
PËRDITËSOHEN!**

- A ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm?
- A ka përmirësime që ende janë të nevojshme?
- A kanë vërejtur punëtorët tuaj ndonjë problem?
- A keni mësuar ndonjë gjë nga aksidentet e ndodhura apo të shmangura?
- A është regjistruar ndonjë sëmundje e re që ndërlidhet me pozitën në punë?



AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar në Shtojcë. Një gjë e tillë do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive shëndetin dhe sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Mbani mend: Vlerësimi i Riskut mund t'ju ndihmojë të menaxhoni çdo rrezik në vendin e punës. Angazhoni punëtorët tuaj/përfaqësuesit e tyre të bëjnë vlerësimin e rrezikuar. Kërkoni ndihmë nga praktikuesi i SHSP-së, kurdo që është e nevojshme.

Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.



SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për “Vlerësimin e Riskut” (Dokumenti Udhëzues), siç janë marrë nga dokumenti i listës së kontrollit të konsoliduar të Auditimit të SSHP-së të BE-së , i zhvilluar në mars të vitit 2021, janë paraqitur si më poshtë:

Seksionet referuese:

2.1.1. Mikroklima

2.6.1. Disponueshmëria dhe Cilësia e Dokumentacionit të Vlerësimit të Riskut, Disponueshmëria e Specialistit/Ekspertit të Çertifikuar të SSHP, Ofruesit të Licencuar të SSHP

2.2.1. Agjentët kimik

2.2.5. Atmosfera eksplozive

2.3.4. Lëvizjet e përsëritura

1. A ishin të përfshirë përfaqësuesit e punëtorëve dhe punëtorët që punojnë në vendin përkatës të punës në vlerësimin e riskut në vendin e punës?
2. A ka ndonjë dokument të shkruar për vlerësimin e riskut në vendin e punës?
3. A janë përgatitur dhe nënshkruar dokumentet e vlerësimit të riskut nga një prej këtyre personave: 1) Personat që kanë kualifikime themelore të sigurisë dhe shëndetit në punë; ose 2) Personat që mbajnë kualifikim të avancuar të sigurisë dhe shëndetit në punë ose 3) Personat që mbajnë certifikatë të ekspertit të sigurisë dhe shëndetit në punë ose 4) Kompanitë e licencuara që japin shërbim të sigurisë dhe shëndetit në punë.
4. A përmbajnë këto dokumente informacionet, siç përmbahen në Rregulloren (MPMS) Nr. 02/2021, neni 11.2, 15.1), siç janë data e vlerësimit të riskut në vendin e punës, emri i ndërmarrjes, Identifikimi (emri) i vendit të punës ose procesi i punës (p.sh. departamenti, përkatësia, lloji i punës etj.) dhe detaje të tjera specifike.
5. Bazuar në identifikimin e rreziqeve në vendin e punës, a janë bërë matjet e mëposhtme laboratorike të rreziqeve në vendin e punës? [Rregullorja (MPMS) Nr. 02/2021, Neni 7.3, 7.4. * Nëse matjet janë të nevojshme, por nuk janë kryer, kontaktoni një ofrues përkatës të shërbimit për t'i organizuar ato.]: (Nëse është e nevojshme/sipas rastit) zhurma, dridhja e krahut, dorës dhe e gjithë trupit, mikroklima (temperatura e ajrit, lagështia e ajrit, shpejtësia e ajrit), ndriçimi, përqendrimi i pluhurit në ajër në vendin e punës, përqendrimi i kimikateve në ajrin e vendit të punës, rrezatimi elektromagnetik, energjia elektrike, rrezatimi jonizues, rrezatimi optik, substancat kimike, pluhuri dhe fibrat, lëvizja e përsëritur, atmosfera shpërthyesë dhe sende të tjera të ngjashme të rrezikshme siç identifikohen si pjesë e rreziqeve VR.
6. A janë të integruara rezultatet e lartpërmendura të matjeve laboratorike në dokumentin e vlerësimit të riskut në vendin e punës?
7. A janë bërë këto matje nga laboratoritë e akredituara nga bordi kombëtar i akreditimit në përputhje me standardin ndërkombëtar: ISO/IEC 17025 "Kërkesat e Përgjithshme për Kompetencën e Laboratorëve të Testimit dhe Kalibrimit" dhe që metodat dhe pajisjet e përdorura për të kryer matjet laboratorike janë



në përputhje me Standardet përkatëse dhe aktuale Evropiane ose/dhe Ndërkombëtare dhe/ose udhëzimet e organizatës ndërkombëtare (p.sh. Organizata Botërore e Shëndetësisë)?

8. A është rishikuar dokument i vlerësimit të riskut në vendin e punës pasi të kenë ndodhur ndryshimet në mjedisin e punës (nëse ndodhë)?
9. A është rishikuar dokumenti i vlerësimit të riskut në vendin e punës pasi ka ndodhur ndonjë aksident në punë (nëse ndodhë)?
10. A është rishikuar dokument i vlerësimit të riskut në vendin e punës pas regjistrimit të sëmundjeve sipas pozitës në punë (nëse ndodhë)?
11. A u kushtohet vëmendje e veçantë gjatë vlerësimit të riskut në vendin e punës grupeve të mëposhtme të ndjeshme që janë në rrezik të veçantë ose kanë nevojë të veçanta (nëse ka): Gratë; Gratë shtatzëna dhe gratë gjdhënëse; Punonjës të rinj; Punonjësit e moshuar; Punonjës me aftësi të kufizuara; Punonjësit me sëmundje ekzistuese, etj.
12. A është në dispozicion të punëdhënësit një përshkrim me shkrim i metodës së përdorur për vlerësimin e riskut në vendin e punës?
13. A zgjidhen PMP bazuar në vlerësimin e riskut në vendin e punës?
14. A janë marrë masa për të kryer mbikëqyrjen e shëndetit të punonjësve për të cilët vlerësimi i riskut tregon rrezik për shëndetin e tyre që rrjedh nga dridhjet ose rreziqet e tjera?